



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.23, datë 18.10.2023

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“PARKU FOTOVOLTAIK “ERSEKA SOLAR PARK 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 MW”,
ME VENDNDODHJE NË STARJE, BASHKIA KOLONJË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Parku fotovoltaik “Erseka Solar Park 2”, me kapacitet të instaluar 20 MW”, me vendndodhje në Starje, Bashkia Kolonjë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.




MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



A circular official stamp in blue ink is partially obscured by a large, stylized handwritten signature in blue ink. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRI' at the top, 'MINISTRI I LINJËS DHE ENERGJISË' on the sides, and 'TIRANË' at the bottom. The signature is written over the stamp and extends to the left.

SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



A circular official stamp in blue ink is partially obscured by a large, stylized handwritten signature in blue ink. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRI' at the top, 'AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT' on the sides, and 'KRYEMINISTRI' at the bottom. The signature is written over the stamp and extends to the right.

Nënskruar më datë 19 / 12 /2023